



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 89, Prot

Durrës, më: 13.01.2026

V E N D I M

Nr. 02, datë 13.01.2026

PËR

"NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK, PËR DHËNIEN E TITUJVE AKADEMIKË "PROFESOR I ASOCIUAR" DHE "PROFESOR", NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 gërma (i), neni 46; të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Statutin e UAMD-së, neni 15 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1 gërma (q), neni 23 "Komisionet e Përherëshme" pika 2 gërma (a) dhe pika 3; si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me nr. 41/1 prot., datë 09.01.2026, në mbledhjen e datës 13.01.2026, Senati Akademik;

V E N D O S I :

1. Ngritjen e Komisionit të Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik (KPPPA), për dhënie të titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Komisioni do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, pjesë e personelit akademik me kohë të plotë, me përfaqësi nga secila njësi kryesore, të cilët mbajnë titullin akademik "Profesor".
3. Anëtarët e KPPPA-së zgjidhen për një mandat 2- vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
 - Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE)
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

